

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"S'ka celular, merrni laptop"/ GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/s039ka-celular-merrni-laptop-gjkkko-nuk-terhiqet-nga-r-regullorja-censurue-i586654
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 10:31:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 10:30:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	25f55f8bacdd4243c8cd54a6be5b7fa8b50fbfc47c4321a011bd53e6e49e709b
TEKSTI	918f48de29c4668470e1ea646f21064edfe9b80e2d1a7bd2443263ec2d0294d7
PAMJA	b8d52c29ef937ef9cd521ec77f3b216556f8b34e5b2eb1f08b800cb7c9bfff5f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2e8514468818092883cfbb284c98e95abcd4d12d31d617af1ffbe66622fb3e17
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa9e18560c1a0d5b17c6b891acdb8aec89255b460c70dc766ecaf13d039759d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2e8514468818092883cfbb284c98e95abcd4d12d31d617af1ffbe66622fb3e17>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie "S'ka celular, merrni laptop"/ GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore! fundit

"S'ka celular, merrni laptop"/ GJKKO nuk tërhiqet nga rregullorja censuruese, i përgjigjet avokatëve: Zbatojeni, ose ndiqni rrugët ligjore!



17 Shtator 2026, 12:30Kronika TEMA

GJKKO nuk e ka në plan të tërhiqet nga rregullorja e re censuruese, që prek jo vetëm mediat por edhe avokatët, të cilët kishin kërkuar rishikimin e saj. Në një përgjigje drejtuar Dhomës së Avokatisë, GJKKO iu thotë avokatëve, të cilët deri më tani kanë bojkotuar gjyqet, që të zbatojnë rregulloren ose në të kundërt të ndjekin rrugët ligjore.

Në letër GJKKO u thotë avokatëve që kontestimi i rregullores nuk duhet të shërbejë për bojkot gjyqesh. Sipas GJKKO, celulari i është ndaluar edhe prokurorëve, gazetarëve, gjyqtarëve.

Në një përgjigje drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, GJKKO argumenton se rregullat e reja të sigurisë janë të ligjshme, të nevojshme dhe proporcionale, duke i lidhur ato me natyrën e çështjeve që shqyrton, nga korrupsioni i nivelit të lartë te krimi i organizuar.

Gjykata kundërshton gjithashtu pretendimin se telefoni celular duhet të konsiderohet "studio e lëvizshme" e avokatit, ndërsa bën dallimin me kompjuterin portativ, përdorimi i të cilit mund të lejohet për shënime dhe konsultimin e dokumenteve gjatë seanceve.

KOMITATI E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR KANCELARI

Nr. 3283/prot.

Tiranë, më 16.09.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 228 prot., datë 01.09.2026 me lëndë: "Kërkesë për rishikimin e dispozitave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

**Z. Maksim HAXHIA
KRYETAR I
DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË**

TIRANË

I nderuar z. Haxhia,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 228 prot., datë 01.09.2026¹, përmes së cilës shprehet mosrënia dakord lidhur me zbatimin e disa dispozitave të Rregullores së Brendshme "Për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".

të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO)“ (në vijim Rregullorja), dhe në veçanti me kërkesën për rishikimin e nenit 76 të saj lidhur me mbajtjen dhe përdorimin e telefonave celularë në sallën e gjykimit, GJKKO-ja çmon të nevojshme të sqarojë dhe parashtrojë sa më poshtë vijon:

1. Fillimisht GJKKO-ja gjën me vend të theksojë se vlerëson rëndësinë thelbësore të rolit të avokatit në garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor, si dhe e konsideron dialogun institucional me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë pjesë të rëndësishme të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë. Avokatia është një komponent i domosdoshëm i administrimit të drejtësisë dhe ushtrimi i lirë, i pavarur dhe efektiv i funksionit të mbrojtjes përbën një garanci që GJKKO-ja ka detyrimin ta respektojë dhe ta sigurojë.
2. Sikurse është e njohur edhe nga përvoja profesionale e shumë anëtarëve të Dhomës së Avokatisë që ushtrojnë veprimtarinë pranë GJKKO-së, natyra e posaçme e juridiksionit të saj dhe karakteristikat e çështjeve që shqyrtohen kërkojnë, njëkohësisht, standarde të shtuara të sigurisë. Në sallat e gjykitimit administrohen

¹ Protokolluar nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 3099 prot., datë 02.09.2026.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Sekuestrohen dy celularë të paligjshëm në burgje, procedohen 8 persona

11:30 Kronika

"Nuk më janë vënë në dispozicion të gjitha fashikujt" - Shtyhet gjyqi i themelit për Ilir Metën, ja kur do të mbahet
seanca e radhës

11:00 Kronika

VIDEO/ Transportonte me makinën "Porsche" 13 lingota floriri kontrabandë, arrestohet 30-vjeçari

10:40 Kronika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.